



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 187/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Afijete Sada Gllgjani dhe Kymete Kicaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në hapësirë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.187/2019 e datës 02.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialit promovues të subjektit politik në hapësirë publike.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 02.10.2019, ka pranuar ankesën Anr.187/2019, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën theksohet se zyrtarët e Shtabit Zgjedhor të LDK-së, më datë 02.10.2019 rreth orës 13:00, në sheshin “Nëna Terezë”, saktësisht në Orën e Qytetit dhe në banesë kolektive, ngjitur me objektin e Inspektoratit të Punës, në Prishtinë, kanë vërejtur dhe fotografuar vendosjen e një posterit të kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik PDK, Mërgim Lushtaku, veprim ky i cili sipas tyre bie në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës, përkatësisht nenin 33 pika b), dhe me Rregullën Zgjedhore Nr.11/2013 dhe atë Nr. 13/2013, duke propozuar që subjekti politik PDK, të sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi. Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur dy fotografi në cilësi të provave materiale.

Subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, në përgjigje në ankesë të datës 03.10.2019, ka theksuar se për vendosjen e posterit të kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik PDK, Mërgim Lushtaku, në sheshin “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, sipas ankesës janë marrë masa përmirësuese, ashtu që është bërë largimi i posterit në fjalë, gjë të cilën e provon fotoja e bashkangjitur në përgjigje në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 2, të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar, për këto arsye:

Paneli, vlerëson se pretendimet e paraqitësit të ankesës janë të pabazuara, për faktin se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur të argumentojë pretendimet e veta, se nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), janë bërë veprime, të cilat kualifikohen si shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe të Rregullave Zgjedhore.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet e paraqitura në ankesë, lidhur me vendosjen e posterit në banesë kolektive, ngjitur me objektin e Inspektoratit të Punës, në Prishtinë, Paneli i vlerësoi si të pabazuara për faktin se nga fotografia të cilën paraqitësi i ka bashkangjitur ankesës, nuk mund të shihet qartë se për çfarë lokacioni bëhet fjalë. Në foto shihet se është vendosur një poster, por nuk mund konstatohet se i njëjti është vendosur në objekt publik, andaj në një situatë të tillë, Paneli e refuzoi ankesën e subjektit politik LDK, për faktin se paraqitësi i ankesës nuk arriti që të argumentojë pretendimet e tij, se nga ana e subjektit politik PDK, janë shkelur dispozitat ligjore të LZP-së dhe të Rregullave Zgjedhore.

Lidhur me pretendimin e paraqitësit të ankesës, për vendosjen e posterit në sheshin “Skënderbeu”, në Prishtinë, PZAP-i, ka vendosur me vendimin Anr.149/2019 të datës 02.10.2019, sipas ankesës së Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë. Prandaj nisur nga kjo gjendje faktike rezultoi se vendosja e posterit të lartcekur, sipas ankesës së LDK-së, është çështje e vendosur me vendimin e lartpërmendur dhe vlerësohet si çështje e gjykuar.

Nga arsyet e theksuara më lartë, e duke u bazuar në nenin 115 par.1 dhe nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.187/2019 më datë 05.10.2019

Kryesues i Panelit

Adnan Konushevci



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.